

Nxënësve në Ferizaj u gjenden 40 thika, 5 pistoleta, 2 pushkë e drogë





24/06/2022 14:33



LAJME TË FUNDIT

- 

Fajon: E kuptoj zemërimin ndaj BE-së, kujtoni kur...
- 

James Rodrigues përfshirë në largimet nga ai...
- 

Edward Joseph: Nuk mund të përjashtohet mundësia qe...
- 

Planet për fermën e...

Policia e Kosovës, ka njoftuar se gjatë një aksioni të policisë në shkollë në qytetin e Ferizajt, kanë gjetur një arsenal armësh të ftohta por edhe armë zjarri.

PK-ja njofton se gjatë kontrollit janë gjetur pesë armë zjarri pistoleta, dy armë të gjata gjysmë automatike dhe 40 thika, shkruan lajmi.net.

Po ashtu është gjetur edhe sasi e drogës.

Njoftimi i plotë i Policisë:

Aksioni i policisë rajonale rreth shkollave në Ferizaj

Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj , përkatësisht Sektori Rajonal i Hetimeve në koordinim me Drejtorinë e Arsimit të komunës së Ferizajt dhe nën autorizim të Prokurorisë Themelore të Ferizajt , mbi bazën e disa informacioneve që ka pranuar rreth dukurive negative të nxënësve dhe personave tjerë në shkollë dhe përreth tyre, që në fillim të muajit shkurt 2022 kishte nisur një aksion i koduar "Siguria në shkollë 2022" .

Në kuadër të këtij plani, pas disa kontrolleve të zhvilluara nga hetues rajonal me rroba civile, të mbështetur edhe nga njësi tjera , kanë ndaluar dhe kontrolluar shumë nxënës në afërsi të shkollave , dhe persona tjerë në rrugë të ndryshme të qytetit . Gjithashtu, janë bastisur dhe kontrolluar disa lokale zhtëpi dhe objekte perçpellesë, ku si prova materiale janë gjetur dhe konfiskuar :

- Armë zjarri (pistoleta), pesë (5).
- Armë të gjata gjysmë automatike dy (2) ,
- Sasi e municionit,
- Thika, 40 copa, kryesisht të nxënësve të shkollave të mesme,
- Boksa metall, 10 copë, të nxënësit e shkollave të mesme,
- Mulli për bluarje të marihanës 6 copë,
- Shufra metall, 4 copë,
- Elektro shok, 1 copë.


Nëse janë ndaluar dhe shoqëruar në polici , dyzetë (40) persona me dyshimin se kanë përdorur narkotikë dhe ndaj tyre janë inicuar raste në Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore të Ferizajt.

Gjithashtu janë ndaluar dhe shoqëruar në polici edhe njëzetë (20) persona me dyshimin se kanë shitur narkotikë (marihuanë) dhe ndaj tyre janë inicuar raste penale për Prokurorinë Themelore të Ferizajt.


Aksioni i policisë do të vazhdojë edhe në etapat tjera, nga muaji shtator-2022, me fillimin e procesit të mësimi, me synim parandalimin dhe luftimin e dukurive negative rreth dhe nëpër shkollë. **Lajmi.net**



Artikuj të ngjashëm




June 25, 2022
Fajon: E kuptoj zemërimin ndaj BE-së, kujtoni kur Kosova përmbushi kushtet...



June 25, 2022
Edward Joseph: Nuk mund të përjashtohet mundësia që të ketë konflikt...



June 25, 2022
Një kamion i rrëqullisur dhe një BMW e shtypur, dalin pamjet...



June 25, 2022
Lokali në Prishtinë ua bën "me viza" hyrjen shtetase të BE-së



June 25, 2022
Kurti i takon disa kryetarë e nënkryetarë komunash



June 25, 2022
Hapet pishina e Gërmisë, angazhohen 12 shpëtimtarë

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr: Zenel Sahnu nr. 28, zyra nr. 5

RRJETET SOCIALE

